



Platformë Televizive
Dixhitale Tokësore
dhe Satelitore

Digital Television
Platform Terrestrial
and Satellite

V E N D I M

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Nr. 5 Datë 21.07 /2014

Sot, më datë 21.07.2014 në orën 11:00 në selinë e shoqërisë "DigitAlb" sh.a u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Digit Alb" në zbatim të nenit 136 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Pasi u verifikua pjesmarrja e përfaqësuesve të saj, rezultoi se janë të pranishëm në mbledhje të gjithë Aksionaret të cilët konfirmuan se janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e kësaj mbledhje sipas procedurës së përcaktuar në ligj dhe në Statut.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ka për rend dite:

- Ndryshimin e Statutit për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë;
- Shtimin e objektit të veprimtarisë/aktivitetit;

Në përfundim të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pasi u diskutua rendi i ditës, mbështetur në nenin 135 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Statutit të Shoqërisë "DigitAlb" sh.a, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e nenit 2 të Statutit të Shoqërisë duke shtuar objektin e veprimtarisë/aktivitetit të shoqërisë.

2. Neni 2 i Statutit behet si vijon:

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Ndertimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit dhe transmetimeve televizive
- Tregtimi i aparaturave për sistemet e transmetimit dhe marrjes së vleve televizive
- Prodhimi transmetimi dhe shitja në mënyrë dixhitale e produkteve dhe shërbimeve audio e video.
- Prodhim filmave artistike që çdo lloji dhe çdo metrazhi, organizim i aktiviteteve kinematografike, artistike dhe audiovizuale të çdo lloji, dokumentare, show televiziv, emisione, spektakle, videoklipe dhe çdo lloj forme tjetër prodhimi audio apo audiovizive të njohur apo që do të ekzistojë në të ardhmen, si dhe distribucioni dhe shpërndarja e tyre në çdo formë në Shqipëri dhe jashtë saj.



Vendim i Asamblesë së Aksionarëve të "DigitAlb sh.a. date/...../2014
"Për ndryshim Statuti, shtim të objektit të veprimtarisë/aktivitetit"

Face 1/2

(Signatures)

ne ecim me hapin e kohës

Pavaresisht cdo dispozite tjeter te ketij Statuti, ndryshimi i objektit te Shoqerise si me larte mund te behet vetem me voten pro (miratuese) te zoteruesve te jo me pak se 8/9 te te drejtave te votes ne Asamblene e Pegjithshme te Aksionareve dhe brenda kufijve dhe konform modalitereve te lejuara nga legjislacioni.

- Ngarkohet Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë DigitAlb Sh.A, z.Alban Jaho të kryejë veprimet e nevojshme për depozitim në Q.K.R të këtij vendimi.

AKSIONARET

Shoqëria Digit - Alb Sh.a

Vjollca Hoxha

Redia Hoxha

Sara Hoxha

Lorela Hoxha

Itan Hoxha

Petraq Shomo

Arben Taipi

Enkelejd Joti

Alban Jaho

Eduard Poda

Për: "Union Distribucion Service Albania" Sh.p.k

Ilir Karaguni



Ky dokument do te jete i vlefshem dhe me fuqi detyruese ligjore vetem ne rast se secila prej 2 faqeve te tij te jete nenshkruar nga secili prej nenshkruesve te mesiperm.

Vendim i Asamblese se Aksionareve te "DigitAlb sh.a. date ... 01/07/2014
per ndryshim Statuti, shtim te objektit te veprimtarise/aktivitetit"

Faqe 2